

PROGRAMI I KONTROLLIT TË TUBERKULOZIT NË GJEDHË

Përmbajtja

1. Të dhënat historike mbi zhvillimin epidemiologjik të sëmundjes. Error! Bookmark not defined.	
2. Përshkrimi i programit	2
2.1. Survejanca aktive në therore.....	3
2.2. Survejanca aktive në fermat e kategorisë I dhe II	3
2.3. Masat kontrolluese në fermat e kategorisë III, IV dhe V.....	Error! Bookmark not defined.
2.4. Lëvizja e kafshëve	Error! Bookmark not defined.
2.5. Rastet e dyshuara me turbekuloz në gjedhë dhe survejanca pasive	5
2.6. Përcaktimi i statusit	Error! Bookmark not defined.
3. Legjislacioni.....	5
3.1. Organizimi, mbikëqyrja dhe roli i të gjithë aktorëve të përfshirë në program	Error! Bookmark not defined.
3.1.1. Drejtoria e Shërbimit Veterinar	5
3.1.2. Drejtoria Rajonale e Bujqësisë	Error! Bookmark not defined.
3.1.3. Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare.....	7
3.1.4. Shërbimi Veterinar i pushteti lokal dhe përgjegjësitë për inspektimin në thertore.	Error! Bookmark not defined.
3.1.5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.....	Error! Bookmark not defined.
3.1.6. Klinikat Veterinare	7
3.1.7. Fermerët	8
3.2. Raportimi.....	8
3.3. Legjislacioni Kombëtar për turbekulozin në gjedhë.....	Error! Bookmark not defined.
4. Masat e programit të kontrollit të Turbekulozot në Gjedhë.....	Error! Bookmark not defined.
4.1. Përmbledhje e masave të programit.....	Error! Bookmark not defined.
4.2. Përshkrimi dhe përcaktimi i zonave gjeografike dhe administrative dhe periudhës gjatë së cilës do të zbatohet programi	Error! Bookmark not defined.
4.3. Përshkrimi i masave të programit	Error! Bookmark not defined.
4.3.1. Lajmërimi për sëmundjen	Error! Bookmark not defined.
4.3.2. Kafshët dhe popullata e kafshëve target	Error! Bookmark not defined.
4.3.3. Identifikimi i kafshëve dhe fermave.....	10

- 4.3.4. Atribuimi i gjendjes së kafshëve dhe tufave **Error! Bookmark not defined.**
- 4.3.5. Rregullat e lëvizjes së kafshëve **Error! Bookmark not defined.**
- 4.3.6. Testet e përdorura dhe skemat e kampionaturave **Error! Bookmark not defined.**
- 4.3.7. Vaksinimi dhe trajtimi **Error! Bookmark not defined.**
- 4.3.8. Masat në rastet e rezultateve pozitive **Error! Bookmark not defined.**
- 4.3.9. Therja e kafshëve pozitive..... **Error! Bookmark not defined.**
- 4.3.10. Skemat e kompensimit të pronarëve të kafshëve të therura.... **Error! Bookmark not defined.**
- 4.3.11. Treguesit e performancës dhe sasitë e synuara **Error! Bookmark not defined.**
- 5. Kostot dhe përfitimet e programit..... **Error! Bookmark not defined.**
 - 5.1. Kostot e vlerësuara **Error! Bookmark not defined.**
 - 5.2. Përfitimet nga zbatimi i programit **Error! Bookmark not defined.**

1. Të dhënat historike mbi zhvillimin epidemiologjik të sëmundjes

Një numër gjedhësh është testuar çdo vit për turbekulozin në gjedhë. Bazuar në burimet në dispozicion, ky numër mund të ndryshojë nga viti në vit. Gjatë 2015, rreth 30,000 kafshë të fermave të mëdha u testuan duke përdorur një injektim të vetëm të turbekulinës në gjedhë. Turbekulina për gjedhë është prodhuar në ISUV. Turbekulina e prodhuar është çertifikuar dhe lejohet për përdorim sipas përcaktimeve të legjislacionit shqiptar. Asnjë testim sigurie nuk është kryer jashtë ISUV.

Informacioni jo zyrtar tregon për prevalencë të ulët në të dy rastet, si në tufa ashtu dhe në kafshë individuale. Asnjë masë mbështetëse nuk u ndërmorr pas konfirmimit të sëmundjes.

Nuk ka informacion të rregullt për inspektimin pas ngordhjes (post mortem) në karkasat e gjedhëve, me qëllim nxjerrjen e mësimeve për turbekulozin në gjedhë.

2. Përshkrimi i programit

Për shkak të mungesës së disa parakushteve që nuk janë vendosur ende (I&R i kafshëve, kontrolli i lëvizjes, kapacitetet laboratorike, kapacitetet monitoruese dhe inspektuese, mbështetja përfundimtare, etj) nuk është e mundur kryerja e testeve të përgjithshme në thertore, në përputhje me standartet e Bashkimit Evropian. Kështu, është përshtatur një mbështetje fleksibël, e përgjegjshme, hap pas hapi, e cila është përshtatur me kushtet e Shqipërisë.

Programi i kontrollit të turbekulozit në gjedhë, fillimisht është i bazuar në survejancën aktive për turbekulozin në gjedhë në thertoret ku ka therje të kafshëve për konsum nga njerëzit. Rastet e dyshuara do të gjurmohen deri në fermën e origjinës. Kjo mënyrë parashikohet vetëm si një hap i parë në programin gjithë përfshirës për kontrollin e sëmundjeve kur survejanca aktive do të nisë në fermat e gjedhëve që janë ndarë sipas kategorive.

Sipas të dhënave nga regjistri i fermave, bazuar në madhësinë e tufës, do të identifikohen pesë kategori fermash.

Tabela 1: Struktura e tufave të gjedhëve

Kategorizimi kombëtar i tufave të gjedhëve në Shqipëri, bazuar në madhësinë e tufës					
Kategoria	Numri i gjedhëve në fermë	Numri i fermave	Numri mesatari gjedhëve për fermë	Numri total i gjedhëve në kategori	Perqindja e popullatës së gjedhëve për kategori
I	>50	198	96	18.971	5
II	21 to 50	532	32	17.228	5
III	11 to 20	1.333	15	19.481	5
IV	5 to 10	7.390	6	46.634	12
V	1 to 4	166.035	2	272.903	73
Numri totali gjedhëve të regjistruara në ferma				375.217	100

2.1 Survejanca aktive në thertore

Nga 2017 dhe në vijim, të gjithë gjedhët e therur për konsum nga njerëzit gjatë inspektimeve “post mortem” do të kontrollohen në lezione. Në raste të dyshimeve për turbekuloz në gjedhë, mostrat do të grumbullohen nga inspektori veterinar në thertore dhe do të dërgohen për konfirmim në laborator. Inspektori Veterinar, menjëherë do të njoftojë Drejtorinë Veterinare për dyshimin duke siguruar gjithashtu informacion zyrtar për fermën e origjinës së kafshës së dyshuar, siç dhe përcaktohet në Çaertifikatën e Shëndetit të Kafshës. Karksat me lezione të dyshuara nga turbekulozi në gjedhë do të trajtohen siç duhet në përputhje me ligjin shqiptar të sigurisë ushqimore.

Drejtoria Veterinare do të gjurmtojë deri në fermën e origjinës për gjedhë pozitivë, duke përfshirë dhe të gjitha fermat ku kafsha e dyshuar ka qenë. Të gjitha kafshët më të mëdha se 6 javë do të testohen duke përdorur testimin interdermal. Në rastet e përgjigjeve pozitive nga testi interdermal i turbekulozit, të gjitha kafshët e dyshuara do të ristestohen duke përdorur testime turbekuline interdermale krahasuese, duke përdorur testime turbekuline të gjedhëve dhe shpëndëve.

2.2 Survejanca aktive në fermat e kategorisë I dhe II

Zbatimi i survejancës aktive në fermat e prodhimit të qumështit të kategorive I dhe II do të nisë në 2018, pasi të ketë nisur me sukses zbatimi i masave të parashikuara në thertore. Nga 2018 dhe në vijim, në fermat e kategorive I dhe II, të cilat janë të fokusuar në prodhimin e qumështit, një herë në vit do të zbatohet një survejancë aktive duke përdorur testimin individual të turbekulinës interdermale tek të gjithë kafshët më të mëdha se 6 javë, ashtu siç dhe përshkruhet në Urdhërin e Ministrit, Numër 505, datë 07.10.2016 (në përputhje me Direktivat e Këshillit 64/432/EEC).

Në rastet e rezultateve pozitive të testimit individual të turbekulinës intradermale, të gjitha kafshët e dyshuara do të ristestohen duke përdorur testime turbekuline interdermale krahasuese, duke përdorur turbekulinën në gjedhë dhe shpëndë.

Në rast të konfirmimit të rezultateve pozitive bazuar në testet individuale, një sërë masash dhe aktiviteteve që janë përshkruar në Urdhërin e Ministrit nr. 298, datë 02.07.2008 (në përputhje me Direktivat e Këshillit 78/52/KE mbi kriteret mbi planin kombëtar për të përshpejtuar çrrënjosjen e brucelozës, tuberkulozit dhe leukozës enzotike në gjedh) duhet të implementohen brenda fermës së infektuar. Masat standarde të kontrollit përveç të tjerash përfshijnë thërrjen e të gjithë kafshëve pozitive duke përfshirë edhe ato që Autoriteti Kompetent (AK) i konsideron si pozitive.

Mostrat për **izolim** e bakterit do të merren nga të gjitha kafshët që do të thërrhen si pasoje e reagimit pozitiv ndaj tuberkulozës në përputhje me këtë program.

Masat e mësipërme do të implementohen çdo vit. Implementimi i sukseshëm i skemës së supozuar (mbështetur në informacionin e sistemit RUDA) do të sigurojë një tip ‘census-i’ mbi tuberkulozin në gjedhë. Vlerësimi i rregullt i rezultateve dhe efekteve, implementimi i programit të kontrollit dhe burimet në dispozicion do të kryhen rregullisht dhe ndryshimet e duhura do të miratohen.

Bazuar në situatën e perceptuar, mund të adoptohet një kategorizim më i avancuar i fermave në lidhje me statusin e tyre shëndetësor dhe politikën eventuale të vaksinimit.

2.3 Masat e kontrollit në fermat e kategorise III, IV dhe V

Megjithëse numri i kafshëve në kategorine III, IV dhe V është i një rëndësie të vecante epidemiologjike dhe ekonomike, në këtë fazë, për arsye praktike, nuk është e arsyeshme të presim implementimin e masave më të avancuara. Një sërë aktiviteteve për të forcuar sistemin e survejancës duke përfshirë edhe kapacitetin e laboratorëve do të sigurojë ShVSh bazat për një implementim më të rregullt të rregulloretë të I&R dhe kontrollit të levizjes, të cilat janë parakushte për kontrollin progresiv të sëmundjes në një situatë të dhënë, dhe të cilat do të kompletohen nga ndergjegjesimet dhe trajnimet efektive.

Paralelisht me implementimin e masave të përshkruara për fermat e ‘medha’ në kuader të të gjithë fermave (duke përfshirë fermat e kategorise III, IV dhe V), është parashikuar implementimi i masave shtese gjithëpërfshirëse që kanë në fokus tuberkulozin në gjedhë e cila përfshin:

- a) Forcimi i një sistemi raportimi ‘pasiv’;
- b) Zbatimi i masave të kontrollit dhe aktiviteteve që janë përshkruar në Urdhërin e Ministrit nr. 298 datë 02.07.2008 dhe pjesën 4.3 në tufat ku është konfirmuar tuberkulozi në gjedhë ;
- c) Testimi i detyruar i të gjitha tufave nga e njëjta njësi epidemiologjike me rastin pozitiv të konfirmuar;
- d) Zbatimi i rregullt dhe i detyrueshëm i inspektimit post mortem i të gjitha kafshëve të thërrura në thërrtore. Në rast të ndonjë rezultati pozitiv, gjurmimi dhe zbatimi i masave sic parashikohen në Urdhërin nr. 298 datë 02.07.2008 dhe pjesa 4.3 e këtij programi duhet të zbatohen.
- e) Financimi (punësimi) i një fushate publicitare që reklamon parandalimin, zbulimin dhe raportimin e sëmundjes.
- f) Forcimin dhe zbatimin e legjisllacionit kombëtar për tuberkulozin në gjedhë.
- g) Financimin (punësimin) e një programi trajnimi gjithëpërfshirës për të gjithë profesionistët veterinarë.
- h) Forcimin e bashkëpunimit me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit dhe Autoritetet e Shëndetit Publik.
- i) Me kusht zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve të parashikuara në tufat e qumështit në kategorite I dhe II, kur të gjitha tufat janë përcaktuar me sukses si status i tipit T2, për të pakten një vit, do të bëhet shtimi i fermave të kategorise III për të zbatuar tashmë skemën e mbikqyrjes dhe si pasoje edhe i fermave të kategorise IV.
- j) Me kusht zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve të parashikuara në tufat e kategorise I, II, III dhe IV, në fund, e njëjta survejancë aktive do të prezantohet edhe në tufat që i përkasin kategorise se V.

- k) Bazuar ne vleresimin e situates epidemiologjike dhe buxhetin ne dispozicion, tufat qe nuk jane per prodhim qumeshti do te perfshihen ne skemen e survejances aktive dhe masat e pershtatshme te kontrollit do te miratohen.

2.4 Levizja e kafsheve

Levizja e gjedhit ne Shqiperi rregullohet sipas legjislacionit aktual shqiptar dhe ne vecanti Urdheri i Ministrit nr. 298 date 02.07.2008 dhe nr. 505 date 07.10.2016.

2.5 Rastet e dyshuara te tuberkulozit ne gjedh dhe survejanca pasive

Tuberkulozi ne gjedh duhet te dyshohet ne te gjitha rastet e semundjeve kronike progresive ose ndonje shenje klinike qe sugjeron tuberkulozin ne gjedh. Tuberkulozi ne gjedh duhet te dyshohet gjithashtu ne rastet kur kafshet kane pasur kontakt te mjaftueshem me kafshe qe jane identifikuar si pozitive me tuberkulozin e gjedhit. Ne raste te tilla, kjo duhet te raportohet pa asnje vonese ne perputhje me Nenin 19 te Ligjit per Sherbimin Veterinare ne Republiken e Shqiperise.

Ne te gjitha rastet e dyshuara, Veterineri Zyrtar do te siguroje nje urdher per Kliniken Veterinare te Kontraktuar qe do te kryeje nje testim intradermal te te gjitha kafshet me te medha se 6 jave.

2.6 Percaktimi i statusit

Ministri i Bujqesise, Zhvillimit Rural dhe Administrimit te Ujrave do te beje marreveshjet per zhvillimin e nje “database” te dedikuar per te mbeshtetur percaktimin e statusit ne perputhje me Urdherin e Ministrit nr. 298 date 02.07.2008 dhe nr. 505 date 07.10.2016. Derisa te krijohet nje “database” i tille, Njesia e Epidemiologjise do te mirembaje infomacionin e cdo rasti ne nje format te pershtatshem.

3 Legjislacioni

3.1 Organizimi, mbikqyrja dhe roli i te gjitha aktoreve kryesore te perfshire ne program

3.1.1. Drejtoria e Sherbimit Veterinar

Ne perputhje me Ligjin e Sherbimit Veterinar ne Republiken e Shqiperise Nr. 10465, date 29.09.2011, **Drejtoria e Sherbimit Veterinar DVSH** kryesuar nga **Kryeveterineri i Republikes ne Ministrine e Bujqesise, Zhvillimit Rural dhe Administrimit te Ujrave (MBZHRAU)** eshte Autoriteti Kompetent (AK) pergjegjes per organizimin e pergjithshem, bashkerendimin dhe zbatimin e Programit te Kontrollit te Tuberkulozit ne Gjedhe (PKTGJ).

Kryeveterineri i Republikes (KR) do te sigurohet qe klinikat veterinare do te kontratohen per te zbatuar disa nga masat sic jane pershkruar ne kete program.

Sektori i Epidemiologjise dhe Identifikimit dhe Regjistrimit te Kafsheve (SE&IR) me Drejtorine e Sherbimit Veterinar ka pergjegjesine per te mbledhur te dhenat, te pergatise dokumentat dhe te ndermarre hapat per te bashkerenduar dhe zbatuar masat e pershkruara dhe te udhezoi Kryeveterineret Rajonal ne perputhje

me kete program kontrolli. SE&IR duhet te perdore bazen e te dhenave ekzistuese te shendetit, identifikimit dhe regjistrimit te kafsheve dhe te beje vizita ne terren. Ne pergjithesi SE&IR do te kryeje se paku aktivitetet e meposhteme:

- 1 Te kryejne detyrat dhe pergjegjesite e dhena nga K/Veterineri i Republikes;
- 2 Te pergatisin dhe organizojne shperndarjen e te mirave te konsumueshme te kerkuara per kete program kontrolli;
- 3 Te udhezoje veterineret private, veterineret zyrtare dhe Kryeveterineret rajonale ne perafrimin e koordinimit per zbatimin e programit te kontrollit;
- 4 Per te mbikeqyrur zbatimin ne terren te programit te kontrollit, veterineret e autorizuar dhe Drejtorite Rajonale te Bujqesise do te kryejne vizita ne terren dhe ne ferma;
- 5 Te mbikeqyre hedhjen e te dhenave nga menaxheret rajonale te te dhenave;
- 6 Te beje vleresime ditore dhe te objektivave, te pergatise te dhena statistikore dhe te kontrolloje cilesine te dhenave te regjistruara;
- 7 Te jape rekomandime per masat e korrektimit;
- 8 Te koordinoje implementimin me Kryeveterineret Rajonale;
- 9 Te kryeje analizimin e pergjithshem te programit te kontrollit;

3.1.2. Drejtoria Rajonale e Bujqesise

12 Kryeveterineret e Qarqeve nen varesine e Drejtorise Rajonale te Bujqesise (DRB) nen drejtimin dhe ne konsultimin e ngushte te K/Veterinerit te Republikes jane pergjegjes per koordinimin dhe zbatimin e aktiviteteve te parashikuara me Programin e Kontrollit te Tuberkulozit ne Gjedh ne qarqet respektive. Eshte pergjegjesi e tyre te sigurojne qe Programi i Kontrollit te Tuberkulozit ne Gjedh te jete zbatuar ashtu sic eshte parashikuar. Per kete qellim, ne vazhdim te hapave te pershkruara me poshte ata mund te ndermarrin masa shtese per te siguruar qe masat jane zbatuar ne perputhje me standartet e parashikuara. Ne vecanti per zbatimin e Programit te Kontrollit te tuberkulozit ne Gjedh, K/Veterineri eshte i detyruar te:

- 1 Siguroje dhe perforcoje veprimet e koordinuara per marrjen korrekte te masave ne perputhje me programin.
- 2 Siguroje qe veterineret zyrtare dhe Klinikat Veterinare qe jane kontratuar te marrin udhezimet e pershtatshme dhe kene njohuri te qarta mbi zbatimin e Programi i Kontrollit te Tuberkulozit ne Gjedh.
- 3 Pas zbatimit te kontroleve te pershtatshme, te autorizojne pagesen per cdo Klinike Veterinare te Kontratuara.
- 4 Pergatisin plan kontrolli te pergjithshem dhe te sigurojne zbatimin e tij.
- 5 Zbatojne masat ne menyre korrekte ne rastet e mos-perputhjeve.

3.1.3. Instituti i Sigurise Ushqimore dhe Veterinaries

3.1.3.1. *Departamenti i Shendetit te Kafsheve*

Laboraret pergegjes per kryerjen e testeve laboratorike ne mostrat e marra nga kafshet e dyshuara ne thertore si pjese e masave te ketij programi jane laboraret nen Departamentin e Shendetit te Kafsheve ne ISUV. Ne vecanti, laboraret kane pergegjesin te:

- 1 Marrin mostra dhe te mbajne te dhena te pershtatshme per gjurmimin e te gjitha mostrave te marra;
- 2 Menjehere, dhe ne cdo rast brenda 24 oreve, te informojne K/Veterinerin e ShVSh (ose personin e emeruar nga K/Veterineri i Republikes), K/Veterineri Rajonal (ose personi i emeruar nga K/Veterineri Rajonal) dhe SE&IR ne cdo rezultat pozitiv qe ka dale Brenda kornizes se ketij programi;
- 3 Pastroje, dezinfektoje dhe te ktheje kutite e transportit tek DRB respektive.

3.1.4. Sherbimi Veterinar ne Pushtetin Lokal pergegjes per inspektimin ne thertore

Inspektoret Veterinare ne thertore kane nje pergegjesi te rendesishme qe eshte inspektimi pas ngordhjes (post mortem) ne karkasat e gjedhit. Inspektoret ne thertore do te mbledhin dhe dergojne mostra nga indet me lezime nga te gjitha kafshet e dyshuara dhe kafshet qe jane therur pasi kane reaguar pozitivisht ndaj tuberkulozit ne gjedh. Inspektori veterinar, nga Certifikata e Shendetit te Kafsheve do te siguroje gjithashtu informacionin per gjurmimin mbrapsht te fermes/ave te origjines te kafsheve te dyshuara.

3.1.5. Autoriteti Kombetar i Ushqimit

Autoriteti Kombetar i Ushqimit (AKU) nen varesi e MBZHRAU ka pergegjesine e kontrollit te ushqimit me origjine shtazore.

3.1.6. Klinikat Veterinare

Klinikat Veterinare te kontratuara jane pergegjese per zbatimin ne terren te masave te pershkruara ne kete program ne perputhje me kerkesat e kontrates, praktikat e mira veterinare dhe legjislacionit kombetar. Ne vecanti, ata jane pergegjes per:

- 1 Kryerjen e testit te vetem intradermal ne te gjitha kafshet me te medha se 6 jave ne kornizen e ketij programi.;
- 2 Në kuadrin e ketij programi, kryerjen e testit intradermal te Perform intradermal nën mbikeqyerjen e Veterinerit Zyrtar;
- 3 Mbledhe dhe raportoje te dhenat e kerkuara ne nje format te pershtatshem dhe brenda afatit kohor sic eshte parashikuar ne legjislacionin kombetar;
- 4 Udhezoje fermerin mbi detyrimet e tij/saj sipas legjislacionit kombetar dhe ne lidhje me tuberkulozin e gjedhit;
- 5 Pas therjes se kafsheve pozitive, te kryeje dezinfektimin ne feramat ku mbahen kafshet.

3.1.7. Fermeret

Ne perputhje me legjislacionin kombetar fermeret kane ne vecanti deyrimet e meposhtme:

- 1 Raportoni menjehere cdo rast dyshimi per tuberkuloz ne gjedh tek VZ dhe/ose tek Klinikat Veterinare te Kontratuara;
- 2 Sigurojne te gjitha mbeshtetjen e nevojshme KVK dhe VZ kur ata kryejne detyrat e tyre zyrtare;
- 3 Te zbatoje masat e urdheruara ne VZ ne rast te ndonje rezultati pozitiv te testit te turbekulines;
- 4 Te zbatoje rregullat e legjislacionit kombetar ne lidhje me tuberkulozin ne gjedhe;
- 5 Te pastroje ambientin ku kafshet jane mbajtur para dezinfektimit.

3.2. Raportimi

SHVSH dhe AKU do të përgatisë dhe zbatojë sistemin e ndërsjellë të raportimit për shkëmbimin e të dhënave të nevojshme për zbatimin e këtij programi të tuberkulozit ne gjedhë. Sistemi i raportimit do te sigurojë shkëmbimin e të dhënave ne kohë në lidhje me permbushjen testeve diagnostike të pershkruara dhe rezultateve pozitive. Ekipte te perbashkëta do të kryejnë vizita ne terren tek fermerët per tu siguruar që masat e percaktuara në legjislacionin kombëtar jane zbatuar në rregull.

3.3. Legjislacioni Kombëtar për tuberkulozin në gjedhë

Urdhëri i Ministrit nr. 298 të 02.07.2008 dhe nr. 505 të 07.10.2016 rregullon masat e vecanta qe duhet të zbatohen në kuader të zbatimit të programit të kontrollit të tuberkulozit te gjedhit dhe janë aplikuar pa paragjykimin e këtij programi kontrolli. Urdhëri I Ministrit është në përputhje me Direktivën e Këshillit 78/52/EEC mbi kriteret mbi planin kombëtar per crrënjosjen e përshpejtuar të brucelozes, tuberkulozit dhe leukozës enzotike ne gjedhe dhe në problemet në shëndetin e kafshëve që ndikojnë në tregëtime ndërkombëtare të gjedhëve dhe derrave.

4. Masat e programit të kontrollit të Tuberkulozit në Gjedhë

4.1. Përmbledhje e masave të programit

Plani i përgjithshëm siç parashikohet është përmbledhur gjerësisht ne tablën e mëposhtme:

Tabela 2: Përmbledhje e veprimit për kontrollin e tuberkulozit ne Shqipëri

Programi i kontrollit të tuberkulozit ne Gjedhë– Përmbledhje					
Viti	Kategoria	Mbikëqyrje		Masat e kontrollit	Masat plotësuese
		Ekzaminimi	Konfirmimi		
2017 në vijim	Thertore	Inspektim i te gjitha karkasave të gjedhëve pas ngordhjes	Vetem testet pozitive intradermal te tuberkulinës do te konfirmohen	Sic është përshkruar ne legjislacionin kombëtar dhe seksionin 4.3 të këtij programi	Mbikqyrja pasive, testi ne thertore, fushata publicitare, trajnime, etj.
2017 në vijim	I, II, III, IV dhe V	Testimi Intradermal i te gjitha kafshëve nga feramat e gjurmua nga kafshët e dyshuara nga thertorja	njekohësisht nga testi intradremal i tuberkulinës; Te gjitha testet pozitive		

2017 në vijim	I, II, III, IV dhe V	Raporte per rastet e dyshuara duke përfshire abortet; investigimet ; testimet e kafshëve te therura ne thertore;	të tuberkulinës do të konfirmohen njëkohësisht nga bakteriologjia		
2018 në vijim	I dhe II	Testi i vetëm intradermal i tuberkulinës			
2019 në vijim*	I, II dhe III	Testi i vetëm intradermal i tuberkulinës			
2020 në vijim*	I, II, III dhe IV	Testi i vetëm intradermal i tuberkulinës			
2021 ne vijim*	I, II, III, IV dhe V	Testi i vetëm intradermal i tuberkulinës			

*Siç është përkthyer në seksionin 2.3. të këtij programi

4.2. Përshkrimi dhe përcaktimi i zonave gjeografike dhe administrative si dhe periudhës gjate së cilës do të zbatohet programi

Masat për kontrollin e tuberkulozit në gjedhe do të zbatohen në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Afati kohor për zbatimin e programit është 2017-2020, periudhë pas së cilës rishikimi i programit është parashikuar. Raporte vjetore dhe rishikimet e përkohëshme do të prodhohen në fund të çdo viti.

Masat e dallueshme në ekonomitë e kategorive të ndryshme do të zbatohen në përputhje me këtë program.

4.3. Përshkrimi i masave të programit

4.3.1 Lajmërimi për sëmundjen

Në përputhje me Ligjin Nr. 10465 dhe Urdhrin e Ministrit nr. 298, janë të detyrueshme raportimi i dyshimeve dhe rasteve të konfirmuara të tuberkulozit në gjedhë. Në përputhje me legjislacionin kombëtar, klinikat veterinare të kontratuara duhet të paraqesin informacion në lidhje me dyshimet duke përdorur procedurat sic përshkruhet në Urdhërin e Ministrit **??/??** për përdorimin e sistemit ADI/RUDA . Raportimi i rasteve të konfirmuara është i detyrueshme për fermerët, veterineret privatë, inspektorët veterinarë dhe laboratorët zyrtarë.

4.3.2 Kafshët target dhe popullata e kafshëve

Nga 2017 e në vijim, të gjithë gjedhët që janë thurur për konsum human në thertore do të jenë subjekt për inspektimin “post mortem” për të kontrolluar lezionet e tuberkulozit në gjedhe. Në rastet e dyshimeve, kampionet do të merren dhe do të dërgohen për konfirmim laboratorik. Fermat e origjinës do të gjurmohen aty ku të gjitha kafshët me të vjetra se 6 jave do të testohen me testet e duhura diagnostike. Nga 2018 e në vijim të gjitha kafshët në fermat e qumeshtit të kategorisë I dhe II, dhe nga 2018 dhe 2019 në vijim kafshët nga fermat e qumeshtit të kategorisë III dhe IV përkatësisht janë të përfshira në skemën e mbikëqyrjes aktive. Përfshirja e kafshëve nga fermat e kategorisë III dhe IV i është nënshtruar zbatimit të suksesëshëm të masave të parashikuara në kategoritë e mëparëshme sic janë treguar në seksionin 2.3. Në të gjitha fermat në rastet e dyshimeve (ngritur nga shenja klinike, raportuar si e dyshimtë nga thertorja) të gjitha

kafshet me te mëdha se 6 javë në tufat e dyshuara do të testohen duke përdorur testin individual intradermal.

4.3.3. Identifikimi i kafshëve dhe identifikimi i fermave

Të gjitha kafshët brënda fermave ku do të kryhet mbikqyrja aktive, dhe të gjitha kafshët brënda fermës ku masat e kontrollit janë zbatuar duhet të identifikohen individualisht.

4.3.4. Atriburimi gjendjes së kafshëve dhe tufave

Atriburimi i gjendjes së tufave përsa i përket turbekulozit në gjedhë nuk është i parashikuar deri në vitin 2020. Vetëm në vitin 2020, në një numër të kufizuar fermash, ku ligjet e veterinarisë janë zbatuar me riorozitet, mund të merret parasysh konsiderimi i përcaktimit të gjendjes së sëmundjes, në përputhje me Urdhrin e Minsitrit, numër 298 dhe nëpërputhje me legjislacionin evropian.

4.3.5. Rregullat e lëvizjes së kafshëve

Levizja e kafsheve të gjalla është rregulluar me ligjin e Sherbimit Veterinar në Republikën e Shqipërisë Nr. 10465 dhe urdhrin e Ministrit Nr. 298 me 02.07.2008 dhe Nr. 505 me datë 07.10.2016.

Në rast të një dyshimi për tuberkuloz në tufe, ashtu si në ndonjë rast pozitiv, bazuar në urdhrin e Ministrit Nr. 892, me vendim të Veterinerit Zyrtar, ferma duhet të izolohet menjëherë. Masa të tilla implikojnë që asnjë gjedh nuk duhet nxjerre nga ferma përveç rasteve të autorizuara nga Veterineri Zyrtar me qëllim që të derghet direkt në thertore pa ndonjë vonesë.

4.3.6. Testet e përdorura dhe skemat e mostrave

Testet zyrtare për diagnozën e tuberkulozit në gjedhe janë përshkruar në Urdhrin e Ministrit Nr. 505 me datë 07.10.2016:

- Test i vetëm intradermal. Ky test përdoret për të gjitha kafshët në tufe nën një skemë survejimi shumë aktive;
- Test krahasues intradermal. Ky test përdoret për të gjitha kafshët japin një rezultat të dyshimtë në testin intradermal. Kafshët që japin rezultat të papërcaktuar në këto teste do të rishikohen si reaktor pozitiv dhe të thërrin nën mbikqyrje zyrtare;
- Identifikim i agjentit nga kultivimi në organizmin e izolimit mesatar primar apo teknika PCR. Ky është testi konfirmues që është përdorur për të konfirmuar infeksionin në mostër nga të gjitha kafshët që janë thërrur si pozitive në testin intradermal krahasues dhe mbi të gjitha kafshët që janë të dyshuar për tuberkuloz të gjedhit, gjatë thërrjes së rregullt për konsum human.

Interpretimi i testeve intradermal është përshkruar me Urdhrin e Ministrit Nr. 505 e 07.10.2016.

4.3.7. Vaksina dhe trajtimet

Pas çdo vaksinimi, është i ndaluar trajtimi terapeutik ose trajtimi i mbindjeshmerisë kundër tuberkulozit në gjedhit.

4.3.8. Masat ne rastet e rezultateve pozitive

Në përputhje me legjislacionin kombëtar, menjëherë me marrjen e njoftimit të dyshimit nga një thertore, Veterineri Zyrtar duhet të kyeje nje investigim zyrtar qe te gjeje fermenten e origjinës si dhe të urdhërojë testimin individual të të gjitha kafshët më të medha se 6 javë në ferme. Kafshët nuk duhet të largohet nga ferma, përveç në rastet kur ata janë dërguar në thertore dhe me miratimin me shkrim nga Veterineri Zyrtar. Këto masa duhet të jenë në vend deri në marrjen e rezultateve nga testimi individual të kafshëve.

Ne rastet kur tuberkulozi është konfirmuar nga testi individual, duhet të izolohet ferma si dhe kafshet me rezultate pozitive nga testi intramendal krahasues ose identifikimi bakteriologjik, duhet të implementohen masa ne perputhje me ligjin kombetar.

4.3.9. Therja e kafsheve pozitive

Perdorimi i mishit te kafsheve pozitive ne kuader te PKBG eshte rregulluar me Urdhrin e Ministrit Nr. **??/??** ne perputhje me legjislacionin European.

Per te siguruar therjen e kafsheve pozitive nen nje survejim zyrtar, MBZHRAU do firmose nje kontrate me nje ose me shume thertore te aprovuara. Thertorja do kete pergjegjesine te mbledhe dhe te there kafshet pozitive nen masa kujdesi specifik.

AKU ne linje me pergjegjesite e saj do te siguroje nje zbatim te plote te legjislacionit mbi te cilin funksionon.

4.3.10. Skemat e kompensimit per pronaret e thertoreve

Kompensimi do paguhet per kafshet qe jane thereur ne kuader te masave te kontrollit te tuberkulozit ne gjedhe ne perputhje me Urdhrin e Ministrit Nr. 892.

Pagesa e kompensimit eshte e kushtezuar, ne varesi te permbushjes se masave qe jane urdheruarnega Veterineri Zyrtar ne perputhje me legjislacionin kombetar.

Me qëllim zbatimin e suksesshëm të programevetë kontrollit të sëmundjeve në Shqipëri, do te duhet te zhvillohen skemat e kompensimit dhe udhezimet qëtë tregojnë se si duhet te behen pagesat e pershtatshme dhe te arsyeshme.

4.3.11. Treguesit e performances dhe targetat sasiore

Targetat sasiore do te bazohen ne numrin e gjedheve te therur ne thertoret shqiptare dhe nga te dhenat e regjistrave te fermereve. Te gjitha kafshet e therura nga 2017 e ne vijim dhe te gjithë gjedhet me te vjeter se 6 jave te fermave te qumeshtit, qe i perkasin kategorise I dhe II, qe nga 2018 dhe ne vijim do te jenë target i testeve individuale te tuberkulines. Te gjitha kafshet nga kategorite e tjera jane target kontrolli sic pershkruhet ne kete program.

Edhe ne nivel tufe, por dhe per kafshet individuale nuk ka asnje informacion te vlefshem per prevalencen e tuberkulozit ne gjedhe, por informacioni rastesor tregon per prevalnce te ulet.

Masat sic jane pershkruar ne kete program do sigurojne qe tuberkulozi ne gjedhe dhe ne tufe te ndonje kategorie te identifikuar si pozitive eshte kontrolluar efektivisht dhe semundja do crrenjose nga keto ferma brenda 3 vjeteve qe nga fillimi i zbatimit te programit.

Masat e perforcuara per levizjen e kafsheve dhe tufave ne feramat e qumeshtit, te kategorive I dhe II sic jane parashikua ne kete program dhe kontrolli i programit te turbekulozit ne gjedhe do siguroje qe keto tufa te mbeten negative. Keshtu qe numri absolut dhe prevalenca e tuberkulozit ne gjedhe ne tufat me qumesht ne kategorine I dhe II ne fund te viti 2019 do jene zero.

Ne stadin aktual prevalenca e ketyre semundjeve ne targetin e fermave te kategorive te tjera nuk dihet, keshtu qe performanca e indikatorëve nuk mund te percaktohet per sa i perket efekteve te zbatimit te masave pershkruese.

5. Kostot dhe dhe perfitimet e programit

Zbatimi i masave të përcaktuara duhet të shihet si një hap i parë në përpjekjet për të filluar me zbatimin e programit të kontrollit të strukturuar për kontrollin e tuberkulozit të gjedhit.

Nese masat zbatohen siç duhet gjate periudhes 2017-2019 atehere rezultati duhet të jete vendosja e një sistemi për mbikëqyrjen e sëmundjes në një pjesë të tufave të gjedhit në Shqipëri.

5.1. Kostot e vleresuara

Kostot e vlerësuara për zbatimin e PKTG janë si më poshtë:

- Shpenzimet për marrjen e mostrave dhe dërgimin e mostrave nga thertoret e cila përfshin konsumit;
- Shpenzimet për KVK për testimet individuale të turbekulines dhe testimin e njekohshem të turbekulines, ku do të përfshihen dhe mallrat e konsumit;
- Shpenzimet për marrjen e mostrave të kafshëve të therura dhe dërgimin e mostrave në laborator;
- Shpenzimet për konfirmimin laboratorik të sëmundjes;
- Kompensimi i fermerëve për kafshët pozitive të therura;
- Shpenzimet për therjen, duke përfshirë transportin e kafshëve pozitive;
- Shpenzimet për pastrim dhe dezinfektim

5.2. Përfitimet nga zbatimi i programit

Përfitimet e përgjithshme që do të vijne nga zbatimi i suksesshëm i PKTG do të reflektohen kryesisht në:

- Gjendja e përmirësuar shëndetësore e kafshëve;
- Rrezik në ulje për shëndetin e njeriut;
- Ulje e humbjeve ekonomike për fermerët;
- Standardet e përforcuara për raportimin e sëmundjeve, I & R, kontrollin e lëvizjes, kontrollin e sëmundjes, etj në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe legjislacionin e BE-së në një pjesë të tufave të gjedhit në Shqipëri;
- Fillimi i përbushjes së standardeve për mundësitë e eksportit.